

Raporti i Transparencës viti 2013
Deloitte Albania



Hyrje

Si një firmë auditimi që kryen auditimin ligjor të llogarive vjetore të entiteteve me interes publik, Deloitte Albania sh.p.k (“Shoqëria”) po publikon raportin vjetor të transparencës në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” lidhur me auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore dhe të pasqyrave financiare të konsoliduara vjetore.

Gjithë informacioni i dhënë në këtë raport lidhet me situatën e Shoqërisë më 31 dhjetor 2013, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

Përshkrimi i strukturës ligjore, organizative dhe pronësia e auditorit të regjistruar.

Shoqëria funksionon si një firmë me përgjegjësi të kufizuara. Mbjajtësit e kuotave të Deloitte Albania sh.p.k janë:

Deloitte Central Europe Holdings limited 100%

Në rastet kur auditori i regjistruar i përket një rrjeti, një përshkrim i rrjetit si dhe të masave ligjore e strukturore në rrjet

Rreth Deloitte

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave anëtare të Deloitte Touche Tohmatsu Limited, e cila është një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë. Secila nga këto firma përfaqëson një entitet ligjor të ndarë dhe të pavarur. Përshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të organizatës Deloitte Touche Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën www.deloitte.com/al/about

Deloitte ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulencës dhe këshillimit financiar, në të gjitha industritë, shoqërive si private ashtu dhe atyre publike. Me një rrjet global firmash anëtare, në më shumë se 150 shtete, Deloitte sjell aftësi me nivel botëror dhe shërbime me cilësi të lartë për klientët e saj, duke i dhënë bizneseve njohuritë që i nevojiten për të adresuar sfidat më komplekse që ato hasin. Pothuajse 200,000 profesionistët e Deloitte janë të angazhuar për t'u bërë standardi i përsosmërisë.

Rreth Deloitte Central Europe

Deloitte Central Europe është një organizatë rajonale entitetesh të organizuara nën kujdesin e Deloitte Central Europe Holdings Limited, firma anëtare e Deloitte Touche Tohmatsu Limited në Europën qendrore. Shërbimet ofrohen nga degët dhe filialet e Deloitte Central Europe Holding Limited, që janë entitete ligjore të veçanta dhe të pavaruara.

Degët dhe filialet e Deloitte Central Europe Holding Limited janë ndër firmat kryesore të shërbimeve profesionale në rajon, që ofrojnë shërbime me më shumë se 3,900 njerëz dhe 34 zyra në 17 shtete.

Deloitte në Shqipëri

Në Shqipëri, shërbimet e auditimit ofrohen nga Deloitte Albania sh.p.k. Shoqëria Deloitte që funksionon në Shqipëri është një filial i Deloitte Central Europe Holdings Limited. Shërbimet e auditimit ofrohen nga zyra e vetme që ndodhet në Tiranë.

Përshkrimi i strukturës drejtuese të Shoqërisë

Shoqëria drejtohet nga drejtorët menaxhues.

Anëtarët e organeve të drejtimit të kompanisë:

- Maksim Caslli
- Elvis Ziu
- Nuriona Sokoli Bërdica

Administratorët e shoqërisë që janë z. Anton Lezhja dhe Znj. Nuriona Sokoli Bërdica, veprojnë si administratorë të Shoqërisë dhe statutit të Shoqërisë në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14 prill 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Deloitte Shqipëri aktualisht punëson 88 punonjës profesionistë për shërbimet e ndryshme që ofron.

Përshkrimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë së Shoqërisë dhe një deklaratë nga administratorët ose drejtuesit mbi efektivitetin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë

Shoqëria mban politika dhe procedura për të promovuar një kulturë të brendshme të bazuar në njohjen që cilësia është thelbësore në planifikimin dhe kryerjen e angazhimit dhe të përcaktuara në Manualin e Politikave të Deloitte (Audit). Ky sistem përfshin politika dhe procedura që adresojnë përgjegjësitë e udhëheqjes për sistemin e kontrollit të cilësisë brenda Shoqërisë, kërkesat etike, pranimin e klientit, angazhimit dhe vazhdimësisë, burimet njerëzore, performancën e angazhimit dhe monitorimin.

Ky sistem i kontrollit të brendshëm të cilësisë ka dy sisteme monitorimi:

- Rishikim i angazhimit të cilësisë dhe sigurisë dhe
- Rishikim i praktikës së firmës anëtare

Rishikim i angazhimit të cilësisë dhe sigurisë

Raportet e auditimit ligjor mbi llogaritë vjetore ose llogaritë e konsoliduara në lidhje me një entitet me interes publik, ndër të tjera, para lëshimit i nënshtrohen një rishikimi të angazhimit të cilësisë dhe sigurisë nga një partner i Shoqërisë me përvojë të mjaftueshme dhe të përshtatshme profesionale.

Rishikimi i angazhimit të cilësisë dhe sigurisë përfshin një rishikim të raportit dhe pasqyrave financiare ose informacioneve të tjera financiare pjesë e raportit, memorandumit të planifikimit të auditimit, ose ekuivalenti, memorandumit të përmbledhjes së auditimit ose ekuivalenti, dokumenta të përzgjedhura të punës dhe dokumentacione të tjera që konsiderohen të përshtatshme si letra e angazhimit. Ky rishikim gjithashtu përfshin një diskutim me partnerin e angazhimit të auditit në lidhje me çështje të rëndësishme që dalin gjatë angazhimit ose rishikimit. Nëse rreziku i angazhimit është vlerësuar si më i madh se normal ose shumë më i madh se normal, një rishikim më i gjerë është i nevojshëm, përfshirë një rishikim të dokumentacionit të përshtatshëm të punës që fokusohet në rreziqet e identifikuar.

Raporti i auditimit mund të lëshohet vetëm nëse rishikuesi është i bindur që ekipi i angazhimit ka bërë gjykimet dhe ka arritur në përfundimet e duhura, dhe angazhimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe rregulloret e tjera sipas rastit.

Rishikim i praktikës së firmës anëtare

Rishikimi i praktikës së firmës anëtare përfshin praktikën e auditimit dhe është projektuar për të vlerësuar performancën e çdo partneri të auditimit të paktën një herë gjatë një periudhe tre vjeçare. Gjatë kësaj periudhe tre vjeçare, të paktën një angazhim për çdo partner përzgjidhet për rishikim. Vëmendje i kushtohet edhe vlerësimit të performancës së manaxherëve, veçanërisht atyre që janë kandidatë për partner në një periudhë afatshkurtër. Siç është përshkruar më lart, Shoqëria është një filial i DCE e cila çdo vit administron programet e veta të rishikimit të praktikës dhe harton programe të tilla për të mbuluar një sërë zyrash. Shoqëria është subjekt i një rishikimi praktike të paktën një herë çdo tre vjet.

Shoqëria është përgjegjëse për rishikimin e praktikës, DCTL ofron udhëzime dhe mbikëqyrje në lidhje me planet dhe procedurat e rishikimit. Koordinimi dhe administrimi i përgjithshëm i programit të rishikimit është përgjegjësia e drejtorit të rishikimit të kompanisë, në bashkëpunim me drejtorin rajonal të rishikimit, kur është e zbatueshme.

Objektivat e rishikimit të praktikës:

- Për të marrë siguri të arsyeshme lidhur me pajtueshmërinë me politikën dhe procedurat e DTTL, përse i përket auditit;
- Për të vlerësuar efektivitetin operativ të manaxhimit të rrezikut dhe procedurat e kontrollit të cilësisë;
- Për të vlerësuar zbatimin e standardeve profesionale dhe kërkesat rregullatore dhe ligjore;
- Për të marrë siguri të arsyeshme se metodologjia e auditimit Deloitte është zbatuar sic duhet; dhe
- Për të marrë siguri të arsyeshme se sistemi i kontrollit të cilësisë të Deloitte Audit është projektuar në mënyrën e duhur, relevante, të përshtatshme, që vepron në mënyrë efektive dhe në përputhje me praktikën.

Gjetjet dhe rekomandimet që rezultojnë nga rishikimet e praktikës paraqiten në një raport rishikimi të praktikës dhe letër të manaxhimit që i adresohet drejtit të Shoqërisë. Qëllimi i letrës së manaxhimit është të ofrojë sygjerrime për përmirësim në përgjigje të gjetjeve të vërejtura. Shoqëria i trajton gjetjet në raportin e rishikimit të praktikës duke hartuar një plan të detajuar veprimi, duke përcaktuar veprimet që duhet të ndërmerren, personat përgjegjës dhe koha për zbatimin e rekomandimeve të paraqitura në letrën e rishikimit të praktikës, kur është e zbatueshme.

Përveç kësaj, Shoqëria i komunikon partnerit përkatës dhe personelit përgjegjës, mangësitë (nëse ka) të vëna në dukje si rezultat i rishikimit të praktikës dhe rekomandimet për masat e duhura korrigjuese. Shoqëria gjithashtu mbi një bazë vjetore komunikon rezultatet e rishikimit të praktikës dhe konsideratën dhe vlerësimin e vazhdueshëm të sistemit të tyre të kontrollit të cilësisë ndaj partnerëve dhe individëve të tjerë brenda Shoqërisë.

Deklarata e komitetit drejtues

Komiteti drejtues i Shoqërisë është i kënaqur që sistemi i kontrollit të brendshëm, siç është përshkruar më sipër, është efektiv në dhënien e sigurisë së arsyeshme që Shoqëria dhe personeli i saj veprojnë në përputhje me standardet profesionale të zbatueshme dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore si dhe që raportet e auditimit të lëshuara janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse.

Të dhëna nga data kur u bë rishikimi i fundit i pavarur i cilësisë dhe sigurisë

Deloitte Albania ka qenë subjekt i kontrollit për cilësinë nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike gjatë dhjetorit 2013. Nga ky rishikim, Deloitte ka marrë vlerësimin "kalon pa gjetje".

Lista e entiteteve me interes publik të audituara nga auditori i regjistruar gjatë vitit të kaluar është paraqitur në Shtojcën 1.

Deklaratë në lidhje me procedurat e pavarësisë të Shoqërisë e cila gjithashtu konfirmon se një rishikim i brendshëm i pajtueshmërisë me pavarësinë është kryer gjatë vitit të kaluar financiar.

Shoqëria vetë mban politika dhe procedura të shkruara të pavarësisë, të cilat përfshijnë kryerjen e kontroleve të caktuara të pajtueshmërisë me pavarësinë në baza vjetore.

- Çdo profesionist duhet të nënshkruajë çdo vit një deklaratë individuale pavarësie. Kjo bëhet çdo vit më 31 maj. Përveç kësaj, konfirmime të ngjashme pavarësie merren nga të punësuarit e rinj dhe ata që lënë kompaninë;
- I gjithë personeli drejtues dhe sipër duhet të japin të dhëna mbi interesat e tyre financiare në Sistemin e Monitorimit Global të Pavarësisë. Portofoli i secilit person kontrollohet me një listë elektronike të klientëve të auditimit për të evidentuar nëse kjo pronësi përkatësisht është e lejuar sipas rregullave të pavarësisë;

- Të gjithë profesionistët duhet të plotësojnë programet elektronike mbi rregullat e pavarësisë dhe;
- Proçeset e procedurat e pranimit të klientit dhe angazhimit përdoren për të verifikuar që pavarësia nuk çënohet.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm në përputhje me politikën e pavarësisë, inspektimit të pavarësisë dhe procedurat e testimit bëhen çdo vit mbi një mostër të profesionistëve dhe zyrtarëve të lartë.

Deklarata mbi politikën e ndjekur nga Shoqëria lidhur me edukimin e vazhdueshëm të auditorëve ligjorë të regjistruar që kryejnë auditime në emër dhe për llogari të firmës së auditimit.

Të gjithë auditorët e kompanisë azhurnojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre teknike dhe profesionale nëpërmjet kurseve të shumta që ofrohen nga vetë kompania si dhe nga kurse apo trajnime që organizohen jashtë kompanisë nga organe profesionale të akredituara.

Edukimi i vazhdueshëm

Edukimi i vazhdueshëm është një politikë kyçe e Shoqërisë, pasi ky është një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e njohurive, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve tona. Deloitte Learning intranet ofron një pikënisje, përfshirë trajnim teknik (GAAP, GAAS, rregullat profesionale, taksa, IT), menaxhimin dhe aftësitë e të punuarit me të tjerë, kurse biznesi, ekonomiku dhe për industri specifike. I gjithë stafi kërkohet që të marrë pjesë në mësimin mbi Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, legjislacionin fiskal dhe rregulloret tregtare të zbatueshme.

Programi i edukimit të vazhdueshëm është i përbërë nga sesione trajnime të organizuara nga Deloitte si dhe trajnime të jashtme. Disa kurse janë të detyrueshme dhe të tjerë janë fakultativë, kështu që çdo auditor ose auditor në trajnim mund të personalizojë programin e tij të mësimin.

Gjatë viteve të para, pjesa më e madhe e trajnimit përbëhet nga kurse të detyrueshme mbi tema teknike duke përfshirë metodologjinë dhe proçeset e Deloitte, por më pas pjesa fakultative rritet, meqë nevojat individuale bëhen më të larmishme. Një program individual mësimi është i nevojshme nga niveli senior 2 (afërsisht 4 vjet eksperiencë).

Auditorët me më shumë përvojë pritet të rinovojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre teknike. Zhvillimi i aftësive drejtuese janë gjithashtu shumë të rëndësishme në këtë grup.

Nëpërmjet një sistemi të monitorimit të automatizuar, është e mundur të kontrollohet situata e kurseve të kryera brenda kompanisë dhe atyre të ofruara nga insitucione të akredituara jashtë kompanisë të ndjekura nga secili auditor. Arsimimi i vazhdueshëm është gjithashtu një faktor që merret në konsideratë për vlerësimin vjetor të personelit të auditimit dhe vlerësimi i potencialit të tyre të rritjes në kuadër të Shoqërisë.

Shuma totale e të ardhurave e auditorit të regjistruar, ndarë përkatësisht sipas shërbimeve të ofruara, në auditimet financiare të pavarura, këshillimet e taksave dhe shërbime të tjera të papërmendura më lart.

Ndarja e shitjeve neto te Deloitte Albania sh.p.k për vitin 2013:

LEK	
Tarifa per auditimin ligjor	34,807,654
Shërbime të tjera sigurie	91,168,671
Shërbime konsulence e të tjera	202,260,889
Totali	328,237,214

Shtojca 1- Entitete me Interes Publik

Entitete me Interes Publik 2013	
National Bank of Greece – Tirana	Bankë
Banka Societe Generale Albania	Bankë
Banka Kombetare Tregtare	Bankë
ANSIG sh.a.	Shoqëri Sigurimi

Deloitte i referohet një ose më shumë Deloitte Touche Tohmatsu Limited, një kompani private britanike e kufizuar me garanci dhe rrjeti i saj i firmave anëtare, secila prej të cilave është një entitet ligjor i veçantë dhe i pavarur. Ju lutem shikoni www.deloitte.al/about për një përshkrim të detajuar të strukturës ligjore të Deloitte Touche Tohmatsu Limited dhe firmave anëtare.

Deloitte ofron audit, taksa, këshillim dhe shërbime këshillimi financiar për klient publik dhe privatë që përfshijnë industri të shumta. Me një rrjet global firmash anëtare, në më shumë se 150 shtete, Deloitte sjell aftësi me nivel botëror dhe shërbime me cilësi të lartë për klientët e saj, duke i dhënë njohuritë që i nevojiten për të adresuar sfidat më komplekse të biznesit. Pothuajse 200,000 profesionistët e Deloitte-s janë të përkushtuar për t'u bërë standardi i përsosmërisë.

Transparency Report 2013
Deloitte Albania



Introduction

As an audit firm that carries out statutory audits of the annual accounts of public-interest entities, Deloitte Albania sh.p.k. (hereinafter: “Company”) is publishing this annual transparency report in compliance with Article 45 of Law no 10091, dated March 5, 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” regarding the statutory audit of the annual financial and consolidated annual financial statements.

All information provided in this report relates to the situation of the Company on 31 December 2013, except if indicated otherwise.

I. Description of the legal, organizational and ownership structure of the registered auditor.

The Company operates as a limited liability company. The quota holders of Deloitte Albania sh.p.k. are:

Deloitte Central Europe Holdings Limited 100%

II. Where the registered auditor belongs to a network, a description of the network and the legal and structural arrangements in the network.

About Deloitte

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and high-quality service to clients, delivering the insights they need to address their most complex business challenges. Deloitte's approximately 200,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence

About Deloitte Central Europe

Deloitte Central Europe is a regional organization of entities organized under the umbrella of Deloitte Central Europe Holdings Limited, the member firm in Central Europe of Deloitte Touche Tohmatsu. Services are provided by the subsidiaries and affiliates of Deloitte Central Europe Holdings Limited, which are separate and independent legal entities.

The subsidiaries and affiliates of Deloitte Central Europe Holdings Limited are among the region's leading professional services firms, providing services through more than 3,900 people in 34 offices in 17 countries.

Deloitte in Albania

In Albania, the audit services are provided by Deloitte Albania sh.p.k. The Deloitte firm operating in Albania is affiliate of Deloitte Central Europe Holdings Limited. The audit services are provided through its only office based in Tirana city.

III. Description of the management structure of Company

The Company is managed by the managing directors.

The Company's managing directors:

- Maksim Caslli
- Elvis Ziu
- Nuriona Sokoli Berdica

The administrators of the company, Mr. Anton Lezhja and Mrs. Nuriona Sokoli Berdica act as administrators of the Company and the Company act in accordance with the Law No. 9901, dated April 14, 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Deloitte Albania currently employs 88 professional personnel among the various business service lines

IV. Description of the internal quality control system of Company and a statement by the administrative or management body on the effectiveness of its functioning internal quality control system

The Company maintains policies and procedures to promote an internal culture based on the recognition that quality is essential in planning and performing engagement and set out in the Deloitte Policies Manual (Audit). This system includes policies and procedures addressing leadership responsibilities for the system of quality control within the Company, ethical requirements, client and engagement acceptance and continuance, human resources, engagement performance and monitoring.

This internal quality control system has two monitoring systems:

- The engagement quality assurance review and
- The member firm practice review.

Engagement quality assurance review

Statutory audit reports on the annual accounts or consolidated accounts relating to a public interest entity, among others, are subject to an engagement quality assurance review by a partner or director of the Company with sufficient and appropriate experience and professional qualifications, prior to issuance of the report.

An engagement quality assurance review comprises a review of the report and financial statements or other financial information subject of the report, the audit planning memorandum or equivalent, the audit summary memorandum or equivalent, selected working papers and other documentation as deemed appropriate such as the engagement letter. This review also includes a discussion with the audit engagement partner as regards significant matters that arose during the engagement or the review. If the engagement risk has been assessed as greater than normal or much greater than normal, a more extensive review is required, including a review of appropriate working papers that focus on the risks identified.

The audit report may only be issued if the reviewer is satisfied that the engagement team has made appropriate judgments and conclusions, and has complied with the International Standards on Auditing and other relevant rules and regulations

Member firm practice review

The Company's practice review covers the audit practice and is designed to assess the performance of every audit partner at least once over a three-year period. During that three-year period, at least one engagement for each partner is selected for review. Consideration is also given to assessing the performance of managers, particularly those managers who are partner candidates in the short term. As indicated, the Company is an affiliate of DCE which administers its own practice review programs annually and designs such programs to cover a number of practice offices each year. The Company is subject to a practice review at least once every three years.

The Company is responsible for the practice review. DTTL provides guidance and oversight regarding the practice review plan and procedures. The general coordination and administration of the practice review program is the responsibility of the Company's practice review director, in conjunction with the regional practice review director, where applicable

The objectives of the practice review are

- To obtain reasonable assurance regarding compliance with DTTL policies and procedures as regards audit;
- To assess the operating effectiveness of risk management and quality control procedures;
- To assess adherence to professional standards and regulatory and legal requirements;

- To obtain reasonable assurance that the Deloitte audit methodology has been properly implemented and
- To obtain reasonable assurance that Deloitte Audit's system of quality control is appropriately designed, relevant, adequate, operating effectively and complied with in practice.

The findings and recommendations resulting from the practice reviews are presented in a practice review report and management letter to the Company's leadership. The purpose of the management letter is to provide suggestions for improvement in response to findings noted. The Company addresses findings in the practice review report by drawing up a detailed action plan setting out the action to be taken, the person(s) responsible, and the timing to implement the recommendations contained in the practice review management letter, where applicable.

In addition, the Company communicates to the relevant partner and other appropriate personnel deficiencies (if any) noted as a result of the practice review and recommendations for appropriate remedial action. The Company also on an annual basis communicates the results of the practice review and ongoing consideration and evaluation of its system of quality control to its partners and other appropriate individuals within the Company

Management Committee statement

The Management Committee of the Company is satisfied that the internal control system as described above is effective in providing reasonable assurance that the Company and its personnel comply with applicable professional standards and regulatory and legal requirements and that audit reports issued are appropriate in the circumstances.

V. Indication of the date when the last independent quality assurance review took place

Deloitte Albania was subject to quality assurance review from the Public Supervisory Board during December 2013. As a result of this review, Deloitte received a "pass without comments" rating.

VI. List of public-interest entities audited by the registered auditor during the last financial year is disclosed in Appendix 1

VII. Statement concerning the Company's independence practices which also confirms that an internal review of independence compliance has been conducted during the last financial year

The Company itself maintains written independence policies and procedures, which include the performing of certain independence compliance checks on an annual basis.

- Each professional should sign an individual independence confirmation each year. It is performed by 31 May each year. In addition, similar independence confirmations are obtained from new employees and employees leaving the Company.
- All managerial personnel and above should enter their financial interests to Global Independence Monitoring System. Each person's portfolio is checked against an electronic list of audit clients to check whether this ownership is allowed under the relevant independence rules;
- All professionals should complete an e-learning on independence rules and;
- Client and engagement acceptance processes are used to verify that independence is not impaired.
- In addition to the continuous monitoring of compliance with independence policies, independence inspection and testing procedures are performed annually on a sample of professionals and senior officers

VIII. Statement on the policy followed by the Company concerning the continuing education of statutory auditors of registered statutory auditors carrying out audits in the name and on behalf of the audit firm

All registered auditors in the Company maintain their continuous professional qualification through a mixture of internal courses as well as educational courses organized by other accredited professional bodies..

Continuing education

Continuing education is a key policy of the Company, as this is an important means of developing knowledge and maintaining and improving the quality of our services. The Deloitte Learning intranet provides a starting point, including technical training (GAAP, GAAS, professional rules, tax, IT), management and interpersonal skills, business economics and industry-specific courses. All staff is required to participate in learning on National Accounting Standards, fiscal legislation and applicable commercial regulations.

The continuing education program is comprised of both Deloitte-organized training sessions as well as external training. Certain courses are mandatory and others are optional, such that each auditor or trainee auditor can personalize their learning program.

During the first years, most training is comprised of mandatory courses on technical topics including Deloitte methodologies and processes but afterwards the optional part increases given that individual needs become more diverse. An individual learning program is required as from senior 2 level (approximately four years' experience).

More experienced auditors are expected to update and deepen their technical knowledge. Developing management and interpersonal skills are also very important for this group.

Through an automated monitoring system it is possible to check the status of internal and external courses followed by an individual auditor. Continuing education is also a factor taken into account for the yearly evaluation of audit staff and the assessment of their growth potential within the Company.

IX. Total amount of the registered auditor's incomes, including divided by respective amounts of services rendered and related to independent financial audits, tax advices and other services not mentioned hereto.

The breakdown of Deloitte Albania sh.p.k for year 2013 net sales:

	LEK
Statutory audit	34,807,654
Other Assurance	91,168,671
Other services	202,260,889
Total	328,237,214

Appendix 1- Public Interest Entities in 2013

Albanian Public Interest Entities	
National Bank of Greece	Banking
Societe Generale Albania	Banking
Banka Kombetare Tregtare	Banking
ANSIG Sh.a	Banking

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.al/about. For a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 200 000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.

© 2014 Deloitte Albania sh.p.k